



Në bazë të nenit 24 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës dhe nenit 55 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31 tetor 2014, merr këtë:

V E N D I M

PËR BARJTEN (RIDEŠTINIMIN) E MJETEVE BUXHETORE TË DISA PROJEKTEVE KAPITALE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Neni 1

Me këtë vendim lejohet bartja (rideštinimi) i mjeteve buxhetore të disa projekteve kapitale të komunës së Rahovecit, të buxhetit për vitin 2014 në shumë të përgjithshme prej **159,518.91 €**, në mënyrë si në vijim:

- Mjetet nga kodi 89708 – Rrërimi i ndërtimeve pa leje në vlerë prej 10,000.00 €, barten në kodin 89710 – Meremetimi i rrugëve fshat dhe qytet.

- Mjetet nga kodi 89736 – Uji i pijshëm në Zatriq, në vlerë prej 15,000.00 barten në kodin 89723 – Furnizim me gypa PVC, meremetimi i kanalizimeve në vlerë prej 8,000.00 € dhe në kodin 89735 – Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve gjatë dy sezoneve në vlerë prej 7,000.00 €.

- Mjetet nga kodi 89721 – Ndriçimi publik, mirëmbajtja e rrjetit ekzistues, në vlerë prej 3,500.00 € barten në kodin 89723 – Furnizim me gypa PVC, meremetimi i kanalizimeve.

- Mjetet nga kodi 89746 – Përkrahja e bizneseve përpunuesve bujqësorë në bazë të kriterëve, në vlerë prej 30,000.00 €, barten në kodin 89747 – Zgjerimi i sistemit të ujitjes në komunën e Rahovecit (fshati Sapniq).

- Mjetet nga kodi 89772 – Ndërtimi i objektit QMF në Apterushë dhe rregullimi i oborrit, në vlerë prej 30,000.00 €, bartet në kodin 89776 - Projektet me bashkëfinancim.

- Mjetet nga kodi 89775 - D.D.D. Dezinsektimi, deratizim, dezinfektim në vlerë prej 5,000.00 € barten në kodin 89776 – Projektet me bashkëfinancim.

- Mjetet nga kodi 89774 – Renovimi i sallës për njësinë satelit për Dializë, në vlerë prej 30,000.00 €, barten në kodin 89776 – Projektet me bashkëfinancim, në vlerë prej 20,000.00 € dhe kodin 89773 – Ndërtimi i objektit QMF në Rahovec dhe rregullimi i oborrit, në vlerë prej 10,000.00 €.

- Mjetet nga kodi 89782 Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin “Anadrintia jehon”, në vlerë prej 10,000.00 €, barten në kodin 89780 – Ndërtimi i terreneve sportive në lagjen e qytetit.

- Mjetet nga kodi 89784 – Ndërtimi i shtëpisë muze Ukshin Hotit, në vlerë prej 10,000.00 € barten në kodin 89780 – Ndërtimi i terreneve sportive në lagjen e qytetit.

- Mjetet nga kodi 89765 – Rregullimi i shtratit të lumit “Rimnik”, në vlerë prej 16,018.91 € barten në kodin 89760 – Hartimi i projekteve të ndryshme si dhe nga kodi i njëjtë vlera prej 3,883.09 € bartet në kodin 89763 – Hartimi i PZHU planet rregulluese.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë pasqyrat e tabelave të projekteve.


Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për financa dhe buxhet.

Neni 5

Ky vendim hy në fuqi nga dita e aprovimit nga ana e Kuvendit dhe konfirmimit mbi ligjshmërinë e saj nga ana e MAPL-së dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës.

01 Nr. 4240
Rahovec, 31 tetor 2014



-III- Nr. i prot. 4240 Më 31.10.2014
Br. prot. 31.10.2014
RAHOVEC - ORAHOVAC



KRYESUESI I KUVENDIT

Nahit Elshani